

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor të vitit 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Seksionit 1 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, (“Rregullorja e Pensionit”) në definimin e Pensionit me Benefit të Definuar dhe Pensionit me Kontribut të Definuar dhe në Seksionin 21 të të njëjtës Rregullore të Pensioneve,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

Rregulla 18 mbi Benefitet e Pensionit Programet e Aplikueshme të Pensioneve Suplementare Individuale

Neni 1 Sfera dhe Qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Siguruesve të Pensionit që sponzorojnë Programin Suplementar Individual të Pensioneve.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull krijon disa direktiva për determinimin e benefiteve dhe vlerës(ve) që mund të ofrohen në Rregullën e Pensionit (Programi) të Siguruesve të Pensionit në mënyrë që të sigurojë se rregullimi i tyre pensional është i vazhdueshëm, i lejuar dhe bazuar në termet e barabarta dhe të pandryshueshme për sigurimin e benefiteve për pjesmarrsit në relacion me vlerën e kontributeve ose ngritjeve të pagës.

Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimet

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definohen më pas në këtë Rregull.

“Benefiti i pensionit të hershëm” nënkupton dispozitën në Rregullat e Pensionit që lejojnë pjesmarrsin që të filloj pensionin e asaj/atij. Një benefit i pensionit të hershëm mund të fillojë kur pjesmarrësi arrin moshën 60 vjeqare.

“Supozimet Aktuariale” nënkupton një sërë vlersimesh që janë shfrytzuar për të llogaritur kontributet për të përcaktuar benefitet e pensionit në rregullimin Pensional me Benefit të

Definuar. Kjo lidhet me zhvillimet e ardhshme që ndikojnë në financimin e benefiteve të pensionit ku faktorët, në mes tjerash, shkalla e interesit, shkalla e mortalitetit, shkalla e invaliditetit dhe ndryshimet në koston e jetesës.

“Pensioni Invalidor” i referohet një të pranueshmi që të filloj benefitet e pensionit para moshës 65 vjeqare për pjesmarrsit që vuajn invaliditetin e kualifikuar të definuar nga SRSG ose me ligj ose statut që i jep atij të drejtën që të pranoj pensionet, ose siq do të definohet në Rregullat e Pensionit.

“Pensioni i shtyer” nënkupton benefitin e pensionit Të Rezervuar (“vested”) për pjesmarrësin në përfundimin e pjesmarrjes së asaj/atij në programin e Pensionit Individual Suplementar që shfaqet para moshës së pensionit mirpo për të cilën fillimi i pensionit shtyhet derisa ajo/ai arrin moshën e pensionit.

“Moshë e Pensionit” nënkupton moshën 65 vjeqare, dhe “benefiti i pensionit normal” nënkupton benefitin e pensionit për pjesmarrësin që ka filluar pasi që ajo apo ai ka arritur moshën e pensionit.

Neni 3 Benefitet e Pensionit

3.1 Programi i Pensionit me Benefit të Definuar i Siguruesit të Pensionit (Kompanitë e sigurimit jetsor)

- a) Bazat në determinimin e Benefitet të Pensionit. Në përgjithsi, Rregullat e Pensionit ofrojnë shumë të përcaktuar ose fikse të benefiteve të pensionit. Rregullat e Pensionit duhet qartë të përshkruajn dhe themelojnë shumën(at) e benefiteve të pensionit në Tabelën e Benefiteve që bazohen në Vlersimet Aktuariale që marrin parasysh elementet si vijojnë:
1. Vlerën e kontributit të dëshiruar.
 2. Numrin e viteve ose muajve për të paguar kontributet.
 3. Moshën e pjesmarrsit.
 4. Tabelën e mortalitetit ose shkallat e shfrytzuara.
 5. Garantitë, dhe nëse aplikohet, shkallët e supozuara të interesit.
 6. Metoda e indeksimit dhe indeksi i referncës i shfrytzuar, nëse shfrytzohe.
- b) Drejtat e Rezervuara për Benefitin e Pensionit. “Drejtat e Rezervuara” definohe në Seksionin 1 të Rregullores së Pensionit dhe në Rregullën 13 të këtyre Rregullave. Të gjitha Rregullat e Pensionit që ofrojnë për Pensionin me Benefit të Definuar duhet të përfshijnë Tabelën e Benefiteve të Pensioneve që i përkohjnë

periodave specifike të pjesmarrjes. Vlera e benefitit(ve) të pensionit në fundë të qdo periode të veçantë është e “Rezervuar”(“Vested”) për pjesmarrsit. Vlera si e “Rezervuar” mund të redukohet vetëm nëse janë plotsuar kërkesat si vijojnë:

1. Vlera e taksave të tilla është caktuar në Rregullat e Pensionit.
 2. Pjesmarrësi “transferon” të Drejtat e tija të Rezervuara.
 3. Taksat janë ngarkuar dhe mbledhur nga Siguruesi i Pensionit në pajtim me kërkesat e Seksionit 3 b) të Rregullës 16, të këtyre Rregullave.
- c) Redukimi, suspendimi ose ndërprerja e kontributeve. Rregullat e Pensionit duhet të sigurojnë për mundësinë e pjesmarrësit që të redukojë, suspendojë ose ndërprejë kontributet dhe duhet qartë të specifikojë metodologjinë ose harmonizimin e benefiteve të pensionit në rast se ndonjera prej këtyre kushteve shfaqet. Kjo gjithashtu do të caktoj të drejtën e pjesmarrësit që të transferoj të Drejtat e tija/saj të Rezervuara në program tjetër të pensionit.
- d) Benefiti i hershëm i pensionit. Nëse përfshihet si benefit në Rregullat e Pensionit, vlera e pensionit për pjesmarrsin i cili zgjedh që të pensionohet para moshës së pensionit, redukohet nga përqindja e specifikuar ose shkalla për qdo numër të viteve që mbeten deri në moshën 65 vjeqare, duke siguruar që vlera e benefitit të pensionit nuk është më e vogël se Drejtat e Rezervuara të Pjesmarrësit siq determinohet prej Tabelës së Benefiteve të përfshirë ose të bëra pjesë e Rregullave të Pensionit.
- e) Benefiti i pensionit invalidor. Nëse përfshihet si benefit në Rregullat e Pensionit, vlera e pensionit të kualifikuar të invaliditetit duhet të jetë me vlerë të fiksuar ose një vlerë fikse dhe e indeksuar për tu përfshirë harmonizimet me ndryshimet në koston e jetesës. Pensioni invalidor duhet të jetë i pagueshëm deri në datën kur invaliditeti pushon, ose në moshën 65 vjeqare ku pjesmarrsi titullohet për pensionin e tij normal. Rregullimet pensionale që ofronë për benefitin e pensionit invalidor duhet të sigurojnë se gjatë periodave të kualifikimit të invaliditetit, pjesmarrsi titullohet që të pranoj pensionin e tij/asaj invalidor dhe të gjitha kontributet për Pensionin e asaj/atij gjatë periodës së kualifikimit të invaliditetit, janë paguar.
- f) Benefiti i partnerit. Nëse pjesmarrësi i cili është i martuar vdes para moshës së pensionit, Pensioni i asaj/atij do të paguhet. Benefiti i Pensionit i llogaritur nëse ai/ajo pensionohet në moshën normale të pensionit bëhet benefit i pensionit të shtyer për bashkshortin/en e tij/asaj.
- g) Pagesa për përfituesit. Nëse pjesmarrsi vdes para moshës së pensionit, mirpo nuk ka bashkshorte, të Drejtat e Rezervuara të atij/asaj duhet ti paguhen përfituesit(ve) të asaj/atij të emruar. Rregullat e Pensionit duhet të specifikojnë mënyrën dhe procedurat për kryerjen e pagesës së benefitit për përfituesin.

- h) Pagesa e benefitit të pensionit. Pensioni duhet të paguhet në baza mujore si fikse ose si e përcaktuar në pajtim me tabelën e benefiteve të përfshira ose janë pjesë e Rregullave të Pensioneve.
- i) Benefitet e pensionit të shtyer. Pjesmarrsi që e ndërprente kontributin e tij, atëherë titullohet që të lë të Drejtën e tij të Rezervuar si pension i shtyer. Pagesat e pensionit mund të fillojnë vetëm, në opcionin e pjesmarrësit, në arritjen e asaj/atij të moshës të lejuar për pension të hershëm, nëse ka, ose në moshën 65 vjeqare. Nëse një individ i cili ka pension të shtyer vdes para fillimit të pensionit, benefitet e pensionit të shtyer do të paguhet në pajtim me Rregullat e Pensionit duke respektuar të drejtat e pjesmarrësit në rast të vdekjes.
- j) Pjesa në një (1) vit të pjesmarrjes do të numrohet në baza proporcionale në determinimin e benefiteve dhe kontributeve të pensionit.
- k) Departamenti i Mbikqyrjes së Sigurimit në BPK mund të përshkruaj Rregullat e aplikueshme për kompanitë e sigurimit jetsor që ofrojnë Pensionet Suplementare Individuale të siguruara ashtu që Rregullat e tilla nuk janë kontradiktore me këtë Rregull.

3.2 Programi i Pensionit me Kontribut të Definuar i Fondit të Pensionit (të gjithë Siguruesit e Pensionit)

- a) Bazat në Determinimin e Benefiteve të Pensionit. Në përgjithsi, Rregullat e Pensionit duhet të ofrojnë se benefitet e pensionit duhet të jenë vlera e mjeteve, e shpërndarë në Ekstraktin e Llogarisë Individuale të Pjesmarrësit në datën e fundit të vlersimit që i paraprin muajit kur pensioni fillon, llogaritet dhe determinohet në pajtim me Rregullën 7 të këtyre Rregullave. Vlera e mjeteve në Llogarin Individuale të pjesmarrësve përbëhet prej:
 1. Kontributet totale të bëra nga pjesmarrësi gjatë periodës së tërë të kontributeve të tij, plus
 2. Fitimet nga investimet të shpërndara në vlerën totale të sqaruar në nenin 1, më lartë.
- b) Vlera e benefitit të pensionit mujor. Siguruesi i Pensionit duhet të blejë një Anuitet prej Kompanisë së Sigurimit Jetsor, në pajtim me Rregullën 11 të këtyre Rregullave për të paguar për pensionet mujore. Vlera e pensioneve mujore përcaktohet nga vlera e fondeve në Llogarinë Individuale të pjesmarrësit prej datës së pensionit, moshës së pensionerit dhe opcionit të setëlimitit të zgjidhur. Rregulla 11 zbatohet në pagesën e pensioneve të pjesmarrësit për Fondet e Pensionit me Kontribut të Definuar.

- c) Drejtat e Rezervuara(Drejtat e ligjshme).”Drejtat e Rezervuara” janë definuar në Seksionin 1 të Rregullores së Pensionit dhe Rregullën 13 të këtyre Rregullave. “Drejtat e Rezervuara” të pjesmarrësit në pensionin me Kontribut të Definuar janë të barabarta me vlerën e mjeteve të shpërndara në Llogarinë Individuale të asaj/atij prej datës së fundit të vlersimit. Vlera e Drejtave të Rezervuara mundë të redukohen vetëm në pajtim me Seksionin 3 b) të Rregullës 16, të këtyre Rregullave.
- d) Benefiti i hershëm i pensionit. Nëse përfshihet si benefit në Rregullat e Pensionit, pjesmarrsi i cili zgjedh që të pensionohet para moshës së pensionit mundë të filloj pensionin e asaj/atij. Vlera e fondeve në Llogarinë individuale të atij/asaj, që përbënë Drejtat e Rezervuara të asaj/atij, prej datës së fundit të vlersimit që paraprin muajin e pensionimit të hershëm të asaj/atij, duhet të shfrytzohe për të blerë një anuitet në pajtim me Rregullën 11 të këtyre Rregullave.
- e) Benefiti i pensionit invalidor. Nëse përfshihet si benefit në Rregullat e Pensionit, vlera e pensionit të kualifikuar invalidor duhet të jetë vlerë fikse ose një vlerë fikse dhe e indeksuar që të përfshijë harmonizimet me ndryshimet në koston e jetesës. Pensioni invalidor duhet të jetë i pagueshëm deri në kohën kur invaliditeti pushon ose në moshën 65 vjeqare kur pjesmarrsi titullohet për pensionin e tij normal. Siguruesit e Pensionit që sigurojnë për benefitin e pensionit invalidor duhet të sigurojë se gjatë periodës të kualifikimit të invaliditetit, pjesmarrsi titullohet që të pranoj pensionin e asaj/atij invalidor dhe të gjitha kontributet e Pensionit të asaj/atij, të paguhen.
- f) Benefiti i partnerit. Nëse pjesmarrsi që është i martuar vdes para moshës së pensionit, benefitet e pensionit të barabarta me Drejtat e asaj/atij të Rezervuara astu siq reflektohen në Llogarinë e tij/asaj Individuale prej datës së fundit të vlersimit para muajit të vdekjes lihen mënjane si benefit i pensionit të shtyer për bashkshorten/in e asaj/atij.
- g) Pagesa e benefiteve të pensioneve. Pensioni duhet të paguhet në baza mujore nëpërmes të një Kontrate Immediate të Anuitetit të blerë nga Fondi i Pensionit ashtu siq drejtohet nga pjesmarrsi në pajtim me Rregullën 11 të këtyre Rregullave.
- h) Benefitet e pensionit të shtyer. Pjesmarrsi që përfundon kontributet, titullohet që të lë Drejtat e tija të Rezervuara si pension i shtyer. Pagesa e pensionit mundë të filloj vetëm, sipas opcionit të pjesmarrsit në arritjen e moshës së asaj/atij të lejuar për pension të hershëm, nëse ka, ose në moshën 65 vjeqare. Nëse një individ i cili ka pension të shtyer vdes para fillimit të pensionit, benefitet e pensionit të shtyer do të paguhen në pajtim me Rregullat e Pensionit duke respektuar të drejtat e pjesmarrsit në rastë të vdekjes.

Neni 4 Rregullat e BPK

4.1 Rregullat tjera të BPK-s të aplikueshme për Siguruesit e Pensionit

Departamenti i Mbikqyrjes bankare dhe/ose Departamenti i Mbikqyrjes së Sigurimit të BPK-s mundë të parashkruajnë Rregullat, të aplikueshmë për Bankat, institucionet financiare dhe/ose kompanitë e Sigurimit Jetsor.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull duhet të hyjë në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm